



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:149288  
Datë: 05.12.2024  
Numri i dokumentit: 06552708

**AC-I-24-0866**

**Në çështjen juridike të:**

***Paditësit/Ankuesit***

**H H, Z B**, fshati I, Deçan, të cilin e përfaqëson avokati B I, Prishtinë

**Kundër**

***E paditur***

**N.SH. "Veselin Maslesha"**, me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Asllan Krasniqi, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-I-24-0010, të datës 01 nëntor 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 05 dhjetor 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.**
- Vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të shkallës së parë i DHPGJS-së, C-I-24-0010, i datës 01 nëntor 2024.**
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 24 maj 2024, paditësi kishte paraqitur një padi dhe propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit kundër vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 29 mars 2024, me nr. Ref.BD-200/16 lidhur me statusin e aseteve të ish ndërmarrjes botuese "Veselin Maslesha" tregtia me shumicë dhe pakicë, Sarajevë KPS1543/PRN2013. Në padi ishte theksuar se Bordi i Drejtorëve kishte gjetur se kjo ndërmarrje dhe çdo aset tjetër i kësaj ndërmarrje e poashtu edhe asetet tjera që do të identifikohen në të ardhmen në territorin e Kosovës janë pronë shoqërore dhe bien nën kompetencat administrative të AKP-së.

Paditësi në rastin konkret ka interes legjitim pronësor sepse i njëjti është aksionar i ish ndërmarrjes shoqërore në fjalë e cila pas privatizimit të saj quhet "Shoqëria Librare dhe Tregtare" "Libraritë-Maslesha", shoqëri aksionare me përgjegjësi të plotë me seli në Sarajevë.

Tutje, në padi ishte theksuar se ish N.SH nga Sarajeva kishte blerë lokalin afarist nga ish Ndërmarrja e Banesave në Prishtinë dhe pastaj e kishte regjistruar filialin e saj në Kosovë. Pas fillimit të procesit të privatizimit kjo ndërmarrje u kishte ofruar në shitje punëtorëve të saj aksione interne duke nënshkruar kontratën për blerjen e tyre duke lënë peng nga një pjesë të pagës ashtu siç kishte vepruar paditësi. Aksionet shiteshin dhe bliheshin duke e lënë të nënshkruar kontratën e veçantë duke specifikuar numrin e aksioneve. Për shkak të situatës që kishte sjellë lufta, aksionarët dhe punëtorët e ndërmarrjes i ishin drejtuar kompanisë bazë me shkresë dhe kishin kërkuar që t'iu sqarohen autorizimet e tyre nga të cilët kishin marrë përgjigje që të vazhdohet veprimtaria. Afati për privatizimin e ndërmarrjes ishte 10 vjeçar ashtu që nga viti 1991 deri në vitin 2001 ishte privatizuar dhe Agjencioni Kantonal i Privatizimit në Sarajevë kishte vendosur që ky subjekt afarist të mund të regjistrohet në regjistrin e kompanive private në Bosnje dhe Hercegovinë. Me vërtetimin nr. 02-506 të datës 13 mars 2015, vërtetohet se në bazë të kontratës nr. . të datës . korrik . ishte bërë bashkimi i mjeteve për blerjen e lokalit afarist i cili gjendet në rr. ". " BL., lokali nr., në sipërfaqe prej 81.19 m2 në Prishtinë, mes Ndërmarrjes Publike Banesore SH.A Prishtinë dhe IRO "Veselin Maslesha" – Sarajevë.

Gjithashtu, paditësi në propozimin e tij për caktimin e masës së sigurisë kishte kërkuar nga gjykata që të caktoj masën e ndalimit të shitjes privatizimit apo shitjes më likuidim e tjetërsim apo ngarkimin të ndonjë të drejte sendore të ish N.SH "Veselin Maslesha", përkatësisht të ndalohej ndryshimi i gjendjes juridike dhe faktike në asete dhe për lokalin afarist derisa të vendoset me aktgjykim të plotfuqishëm. Tutje, kishte theksuar se kjo kërkesë për caktimin e masës është bërë e besueshme në bazë të provave të paraqitura kurse me privatizimin eventual do të shkaktohej dëm i pariparueshëm paditësit, pasi që AKP mund ta shes shumë shpejtë këtë pronë.

Padisë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit i kishte bashkëngjitur këto prova: autorizimin për përfaqësim, një njoftim të AKP-së të datës 22,23,24,25 dhe 26 prill 2024, një kontratë nr..të datës . korrik ., deklaratën e paditësit, kontratën e datës . mars ., përgjigje në kërkesën nr. NH/103/99 të datës 8 shtator 1999, Aktvendimin nr. 21-04/3-19-324-5 të datës 31 korrik 2001,, Vërtetimin nr. 02-506 të datës 13 mars 2015, fletëtransferin e pagesës së tatimit në pronë të datës 26 prill 2023, faturën e tatimit në pronë në emër të paditësit të datës 23 janar 2023, konfirmimin nr. 06/1-733/2 të datës 24 maj 2023 si dhe një shkresë me titullin "Shfrytëzimi i aseteve në pronësi shoqërore" me nr. 2643/2023 të datës 23 tetor 2023.

Me 31 maj 2024, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në padi dhe në kërkesën për masën e sigurisë. Në përgjigje e paditura kishte theksuar se paditësi në padi/propozim nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën ë mbështetë padinë. AKP konsideron se paditësi me padi nuk ka prezantuar asnjë fakt të vetëm me të cilin mund të dëshmoj se është pronar i asetit kontestues dhe se mund ti shkaktohet ndonjë dëm i pariparueshëm nëse nuk aprovohet masa e sigurisë për asetin në fjalë. Andaj, AKP kishte konstatuar se propozimi për masën e sigurisë nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm dhe të bazuar ën fakte të argumentuara se nga mos aprovimi i masës së sigurisë paditësit do ti shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm. Sipas gjendjes reale dhe faktike të krijuar lidhur me përgatitjen e shitjes së objektit kontestues nuk ka gjasa teorike dhe as praktike që ti shkaktohet paditësit ndonjë dëm. Kjo ngase paditësi kërkesën e tij nuk e kishte argumentuar me prova të besueshme materiale lidhur me pretendimet e tij paditore. Lidhur me

propozimin për masën e përkohshme kishte konsideruar se në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet propozimi si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim e të cilat mjete sipas mundësive propozuesi mund t'ia bashkëngjisë propozimit për caktimin e masës së përkohshme. Andaj, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar në ligj padia e paditësit, të hedhet poshtë si e papranueshme kërkesa e propozuesit të sigurimit dhe të refuzohet si e pabazuar në ligj kërkesa për lëshimin e urdhrin paraprak gjyqësor. Gjithashtu, të detyrohet paditësi t'i paguaj shpenzimet procedurale. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur një kërkesë për aprovimin e Raportit përmbledhës të Komisionit për Përcaktimin e Statusit të Aseteve të Ndërmarrjes Botuese "Veselin Maslesha" – Tregtia me shumicë dhe pakicë, me seli në Sarajevë, aseti në Prishtinë e datës 13 mars 2024, Raporti përmbledhës me nr. Ref:KPS1543 dhe PRN213 si dhe një vendim nr. Ref. BD-200-16 të datës 29 mars 2024.

Me 12 qershor 2024, gjykata kishte lëshuar një urdher për paditësin nga i cili kishte kërkuar që të dorëzoj në gjykatë disa prova dhe atë: kontratën mbi regjistrimin dhe blerjen e aksioneve interne të lidhur me datën . mars .. në Sarajevë në mes të paditësit dhe N.SH "Veselin Maslesha", përgjigjen e N.SH "Veselin Maslesha" Sh.a numër NH/103/99 me numër protokollit .. i datës . shtator ., Aktvendimin e Agjencionit Kantonal për privatizimin e ish N.SH "Veselin Maslesha", numër 21-04/3-19-324-5 Sarajevë i datës 31 korrik 2001, dëshminë e tatimit në pronë të datës 26 prill 2023 si dhe konfirmimin me numër protokollit 06/1-733/2.

Me 25 qershor 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në urdhrin e gjykatës të cilës i kishte dorëzuar këto prova: kontratën mbi regjistrimin dhe blerjen e aksioneve interne të lidhur me datën . mars .. në Sarajevë në mes të paditësit dhe N.SH "Veselin Maslesha", përgjigjen e N.SH "Veselin Maslesha" Sh.A numër NH/. me numër protokollit . i datës . shtator ., faturën e tatimit në pronë të datës 26 prill 2023, konfirmimin me numër protokollit 06/1-733/2 të datës 24 maj 2023, faturën për shërbimet e ofruara të ujit nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal Prishtina për muajin 06/2024 si dhe faturën për shërbimet e ofruara të energjisë elektrike nga Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike për muajin 05/2024.

Me 11 korrik 2024, Kolegji i shkallës së parë të DHPGJS-së me Aktvendimin C-I-24-0010 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi ishte theksuar se pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, kolegji kishte vlerësuar se paditësi në këtë fazë të procedurës nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tij. Pretendimet e paditësit duke bashkëngjitur provat në origjinal të vërtetuara nga noteri pas urdhrit të gjykatës janë të pamjaftueshme për aprovimin e masës së sigurisë të kërkuar nga paditësi. Paditësi në rastin konkret nuk ka prezantuar asnjë fakt të vetëm me të cilin mund të dëshmoj se është pronar i asetit kontestues dhe se mund të shkaktohet ndonjë dëm i riparueshëm nëse nuk aprovohet masa e sigurisë për asetin në fjalë. Për më tepër pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me gjendjen faktike sepse prova të besueshme për paraqitjen e dëmit nuk mund të jenë nëse nuk prezantohen edhe provat nga të cilat vlerësohet se paditësi mund të fitoj të drejtën e pronësisë për të cilën kërkon masën e sigurisë.

Me 30 korrik 2024, paditësi/propozuesi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktvendimit C-I-24-0010 të datës 11 korrik 2024, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të miratohet si e bazuar ankesa e ankuesit për vendosjen e masës së sigurisë, të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe të urdhërohet Bordi i Drejtorëve i AKP-së që të ndaloj shitjen-privatizimin, likuidimit me shitje apo tjetërsimin, ngarkimin me ndonjë të drejtë sendore apo detyrimore të ish N.SH, përkatësisht të ndalohet ndryshimi i gjendjes faktike të lokalit afarist derisa të mos vendoset me Aktgjykim të plotfuqishëm. Gjithashtu të detyrohet e paditura të bëj kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit dhe ato të procedurës. Në ankesë ankuesi kishte theksuar se gjykata në rastin konkret nuk e ka marrë parasysh fare kërkesën e ankuesit për afat shtesë që t'i dërgojmë origjinalin e këtij Aktvendimi e madje ekzistimin e këtij Aktvendimi gjykata nuk e kishte komentuar fare e të mos flasim për vlerësim të tij, si provë kryesore në këtë procedurë. Gjithashtu ankuesi thekson se kishte paralajmëruar dërgimin e listës së aksionarëve të kësaj ndërmarrje të privatizuar me qëllim që t'i prezantohet gjykatës por meqenëse bëhet fjalë për komunikim ndërkombëtar sigurisht që duhet kohë që

dokumentet të vijnë në zyrë. Gjithashtu, gjykata nuk kishte marrë për bazë se privatizimi i kësaj ndërmarrje si të gjitha kompanitë tjera të regjistruara në Bosnje dhe Hercegovinë me kapital dhe kontroll të kapitalit të kompanisë amë në Sarajevë me rastin e privatizimit kanë privatizuar edhe filialet e tyre kudo ku ato kanë qenë. Padiësi me provat e dorëzuara në DHPGJS kishte arritur të dëshmojë në kuptim të probatio semiplena një mundësi të lartë se padia e tij është e bazuar. Me privatizimin eventual, para vendimit përfundimtar nga gjykata do t'i shkaktohej dëm i pariparueshëm padiësit. Për më tepër një humbje e pariparueshme e të drejtave pronësore të padiësit do të shkaktohej sipas nenit 1 paragrafi 1, protokollit 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të drejta të cilat nuk mund të zhdëmtohen në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Andaj duke u bazuar në këto që u thanë, ankuesi i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë.

Me 09 gusht 2024, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e ankuesit në të cilën kishte theksuar se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar.

Me 05 shtator 2024, Kolegji i Apelit i DHPGJS, me Aktvendimin AC-I-24-0573 e ka refuzuar ankesën e padiësit si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar Aktvendimin e shkallës së parë C-I-24-0010 të dt. 11 korrik 2024.

Me 24 tetor 2024, në shkallën e parë të DHPGJS, padiësi përsëri ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së sigurisë dhe ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë. Ka theksuar se AKP me dt.21 tetor 2024, i ka dërguar një shkresë padiësit të emërtuar "Shfrytëzimi i aseteve në pronësi shoqërore". Me të njëjtën i ka kërkuara që deri me dt. 02 nëntor të bëjë lirim të lokalit, në të kundërtën e njëjta do të behët me asistimin e policisë dhe do të vendos në listën e uzurpatorëve që AKP i publikon. Ka kërkuara që të vendoset masa e sigurisë duke i ndaluar kundërshtarit të sigurimit shitjen privatizimin, likuidimin me shitje apo tjetërsimin e ndonjë të drejte tjetër sendore si dhënie me qira apo ndonjë barre të detyrimeve ndaja lokalit afarist i cili gjendet në adresën rr. ". " BL-. L E-I. nr.. me sipërfaqe prej 81.19 m2, në Prishtinë deri në vendosjen aktgjykimit të plotfuqishëm.

Me 28 tetor 2024, e paditura ka paraqitur përgjigje në kërkesën për caktimin e masës së sigurisë. E Paditura e kundërshton në tersi si jo të bazuar në ligj, kërkesëpadinë e paditësit për caktimin e masës së sigurimit, duke shtuar se AKP e ka njoftuar paditësin që ta bëj lirim të lokalit afarist pasi që njëjti e shfrytëzon atë pa asnjë marrëveshje me AKP-në dhe pa bazë ligjore. I ka propozuar Kolegjit të Apelit që të refuzohet si e pa bazuar propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurimit pasi që nuk janë plotësuar kushte ligjore për caktimin e saj.

Me 01 nëntor 2024, Kolegji i shkallës së parë të DHPGJS me Aktvendim C-I-24-0010, e ka refuzuar kërkesën për masën e sigurimit si e pa bazuar duke konsideruar se paditësi nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejte e pretenduar në favorin e tij. Shkalla e parë kishte gjetur se pa paragjykuar zgjidhjen meritore me provat e prezantuara nga paditësi nuk shprehin bazë të mjaftueshme për aprovimin e masës së sigurimit siç parsh nenin 61.1 i Ligjit për DHPGJS nr. 06/L-086, lidhur me demin e menjëhershëm dhe të pariparueshëm. Për me tepër Kolegji i shkallës së parë ka konsideruar se paditësi nuk ka theksuar bazën juridike në të cilën mbështetë padia – propozimi për caktimin e masës së sigurimit si dhe gjithashtu padia –propozimi për caktimin e masës së sigurimit është parashtruar në kundërshtim me legjitimitetin aktiv të palës.

Me 18 nëntor 2024 paditësi/ankuesi ka parashtruar ankesë në DHPGJ kundër Aktvendimit C-I-24-0010, të datës 1 nëntor 2024, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJ-së që të miratohet si e bazuar ankesa e ankuesit për vendosjen e masës së sigurisë të anulohet Aktvendimi i ankimuar dhe të urdhërohet Bordi i Drejtoreve të AKP-së që të ndaloj shitjen-privatizimin likuidimin me shitjen apo tjetërsimin, ngarkimin me ndonjë të drejte sendore apo detyrimore të ish N.SH "Veseli". Ankuesi me ankesë pretendon se janë plotësor kushte për caktimin e masës së sigurimit ngase nëse nuk caktohet masa e sigurimit Bordi i AKP-së mund ta shesë shumë shpejt pronën në fjalë dhe kjo prona pastaj nuk mund të kthehet paditësit. Po ashtu e paditura me asistencën e policisë së Kosovës do ta bëjë lirim të lokalit ashtu siç ka theksuar në shkresën e saj drejtuar paditësit. Ka shtuar se

paditësi do të pësoj dëm të pariparueshëm në rast të mos miratimit të kërkesë për caktimin e masës së sigurimit dhe kjo do të shkaktoj pasoja ta pajustificueshëme paditësit në të drejtën e pronësisë, andaj ka propozuara që të caktohet masa e sigurimit.

Me 25 nëntor 2024 e paditura AKP-ja ka paraqitur përgjigje në ankesën e ankuesit në të cilën kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar duke theksuar se Aktvendimi i shkallës së parë është i qartë dhe përmban shpjegim dhe arsye të mjetshushme për refuzimin e kërkesës së paditësit, andaj i ka propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS, që ankesa të refuzohet si e pa bazuar si dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar.

### **Arsyetimi i ligjor**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-I-24-0010, i datës 01 nëntor 2024, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet vërtetuar.

Kriteret se kur duhet të lëshohet Masa e Sigurisë përcaktohen në nenin 61.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: *fumus boni iuris* (probabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe *periculum in mora* (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-



së: cf., inter alia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Me fjalë të tjera: Padiësi/Ankuesi i cili kërkon Masë të Sigurisë duhet të dëshmoj probabilitetin se 1) ekziston rreziku i të drejtës të cilën e kërkon, dhe 2) e drejta është në rrezik të drejtpërdrejtë të humbjes ose dëmtimit të pariparueshëm, nëse nuk lëshohet Masa e Sigurisë e cila kërkohet.

Në këtë lëndë, Kolegji i Apelit vëren se padiësi me propozimin e masës së sigurisë drejtuar shkallës së parë të DHPGJS-së ka propozuar që të aprovoj propozimin e tij për caktimin e masës së sigurisë dhe ti ndalohet AKP-së shitja, tjetërsimi, ngarkimi si dhe ndryshimi i gjendjes faktike i lokalit, ish në pronësi shoqërore i cili gjendet në adresën, Rr. ".", BL-. -. nr.. në sipërfaqe prej 81.19 m2, Prishtinë deri në vendosjen mbi meritat e çështjes. Kontrata nr. . e datës .. mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e lokalit afarist ishte lidhur ndërmjet NSH-së "Veselin Maslesha" Sarajevë dhe " Ndërmarrjes Publike Banësore" Prishtinë. Prandaj mbi këtë bazë Bordi i Drejtorëve të AKP-së me vendimin e datës 13/03/2024 kishte aprovuar statusin e aseteve të saj në pronësi shoqërore në mesin e të cilave ishte edhe lokali afarist kontestues.

Kolegji I Apelit vëren se AKP-ja konteston edhe Legjitimitetin aktiv të padiësit duke kontestuar provat Kontratën mbi blerjen e aksioneve e datës .. e cila është vetëm kopje e pa vërtetuar të cilën gjykata nuk mund të konsideroi si provë të besueshme. Kolegji i Apelit vlerëson se kjo do të jetë çështje e vërtetimit të plotë që duhet ta bëjë Kolegji i Shkallës së parë të DHPGJS-së në procedurën vijuese kur të merret me meritat e padisë e jo tek kërkesa për caktimin e masës së sigurimit

Kolegji i Apelit konsideron se padiësi nuk ka provuar të drejtën e pretenduar, kopja e Kontratës mbi blerjen e aksioneve e datës .. në këtë fazë të procedurës nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshëm për të provuar të drejtën e pretenduar.

Kolegji i Apelit edhe me tej mbetet pran qëndrimin të tij të shprehur sikurse ne Aktvendimin e lëshuar AC-I-24-0573 me dt. 05 shtator 2024, dhe rithekson se padiësi nuk ka parashtruar dëshmi në mbështetje të ekzistimit të dëmit të

menjëhershëm të pronës kontestuese. Kolegji i Apelit vëren se nuk është kontestuese se e paditura i ka dërguar një shkresë paditësit për ta liruar lokalin në mënyrë vullnetare, madje këtë nuk e ka kontestuar as vete e paditura duke u thirrur në at se është detyrim ligjor i saj për ti administruar asete e NSH-së.

Kjo shkresë e AKP-së nuk e ndryshon qëndrimin e Kolegjit të Apelit përkitazi me refuzimin e kërkesë së paditësit për caktimin e masës së sigurimit. Kjo rrethanë e si e vetme e paraqitur nga paditësi nuk mund të konsiderohet si provë mbi ekzistimin e rrezikut të menjëhershëm nga dëmtimi i pronës kontestuese. Kjo mund të konsiderohej vetëm nëse paditësi do ofronte prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Nga këto arsye Kolegji i Apelit vlerëson se Kolegji i Shkallës së parë i DHPGJS-së ka vendosur saktësisht se kushtet e dhëna në nenin 61 të LDHP-së 06/L-086 nuk janë përmbushur në këtë rast.

Prandaj nga këto arsye Kolegji i Apelit e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të Shkallës së parë si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Ky Aktvendim në asnjë mënyrë nuk prejudikon zgjidhjen e meritave të padisë.

Në bazë të këtyre arsyeve e në mbështetje të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi/paditësi e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 27 nëntor 2024 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 05 dhjetor 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues